



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.122/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë , si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik dega në Skenderaj, për shkak të shkeljes së rregullave zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 07 qershor 2017, nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës Veton H. Seferi nga radhër e subjektit politik LVV ka postuar një fotografi me boksierin Robin Krasniqi në kompleksin memorial “Adem Jashari”, duke e përhapur në faqe të rrjetit social Facebook. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se subjekti politik LVV me postimin e kësaj fotoje në rrjetin social Facebook janë shkelur përveç rregullave zgjedhore edhe neni 8 i Ligjit nr.2004/39 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi i ngjarjes dhe një kopje e ligjit nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor Adem Jashari .

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV në përgjigje në ankesë i datës 08.06.2017, thekson se kandidati për deputet i Kuvendit të Kosovës Veton Seferi nga radhët e subjektit politik LVV askund brenda fotografisë nuk ka pasur në posedim të ndonjë materiali propagandues, përmes së cilit do të mund të pretendohet se është duke u zhvilluar ndonjë aktivitet partiak. Për më tepër subjekti politik LVV, ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj lidhur me dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojën për ti aplikuar dispozitat ligjore.

Përmes përgjigjes në ankesë subjekti politik LVV thekson se, kemi ndërmarrë të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe para fillimit të fushatës zgjedhore me shkresën e dërguar përmes postes elektronike, kemi dekurajuar të gjithë personat për të ndërmarrë veprimet që janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet politike, Kandidatët dhe Simpatizantët, prandaj konsideron se PZAP-i me rastin e shqyrtimit të ankesës duhet ta përjashtoj përgjegjësin që i ngarkohet subjektit politik LVV . Në mbështetje të pretendimeve ankimore nuk i ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, vlerësoj se :

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se kandidati për deputet i Kuvendit të Kosovës Veton Seferi nga radhët e subjektit politik LVV, ka shpërndarë një fotografi në kompleksin memorial “Adem Jashari” me bokserin Robin Krasniqi në faqen e rrjetit social Facebook, duke i shkelur rregullat zgjedhore, të njëjtat pretendime ankimore nuk qëndrojnë sepse fotografia e ofruar nga parashtruesi i ankesës si dhe nga pretendimet e theksuara në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LVV vërteton se fotografia është bërë në vendin e dedikuar për kompleksin memorial të “Adem Jasharit”, prandaj ky veprim nuk ka të bëjë asgjë lidhur me fushatën zgjedhore.

Andaj PZAP-i, konstaton se pretendimet e cekura në ankesë janë të pa bazuara, sepse nga prova e paraqitur vërtetohet se postimi dhe shpërndarja e kësaj fotografie përmes rrjetit social Facebook nuk paraqet shkelje të supozuar.

Prandaj, paneli konsideron se parashtruesi i ankesës, me dëshminë e ofruar nuk i ka vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë, në mënyrë që PZAP-i, të merr vendim në favor të tij.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.122/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.